



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 438/3 Prot

Tepelenë, më 27.02.2026

V E N D I M

Nr. 15 datë 26.02.2026

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2025

Këshilli i Bashkisë Tepelenë, në mbledhjen e datës 26.02.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar për zbatimin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2025, mbështetur në:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936/2008, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 51;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2025”, i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2025, i cili është i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor 2025 dhe përfshin:
 - a) Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2025;
 - b) Pasqyrat Financiare të vitit 2025;
 - c) Raportin mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar.



3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 27.02.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK



ARBEN GUMENI